

EUGJEN ONJEGINI- Alexander Pushkin

Enciklopedi e jetës ruse të kohës kur u shkrua romani në vargje.

Veçoritë e artit të Pushkinit:

- Në qendër të veprës qëndron analiza shpirtërore e botës së brendshme të njeriut
- Vepër epiko-lirike
- Dialog i shpejtë
- Personazhet portretizohen
- Përshkrim i natyrës
- Analizë psikologjike
- Gjuhë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, që krijon imazhe

Eugjen Onjegini si figurë me tipare të theksuara realiste:

- 1) I pakënaqur nga realiteti (shkaqet dhe motivet realiste)
- 2) Largohet nga qyteti për rrethana realiste
- 3) Ndryshe nga heronjtë romantikë nuk ka aspirata të larta heroike (ka dëshirë, por s'Vepron)
- 4) Duke ndjekur hapat e jetës së Eugjenit, ne gjejmë heroin tipik realist- përfaqëson një grup të caktuar shoqëror duke filluar që nga fëmijëria
- 5) Evoluimi i heroit- tipar realist
- 6) Në udhëtime shkon për të njojtur vende (jo romantik)
- 7) Heroi realist bashkëvepron me të tjerët, romantiku jo

Tatjana, përmes vargjeve që i drejton Onjeginit

Nga letra e mirënjohur, që Tatjana i dërgoi Onjeginit formësohet portreti i saj si **heroinë romantike**. Ajo është e para femër, së paku e letërsisë ruse, që **thye tabutë shoqërore dhe mentalitetet anakronike**, duke qenë ajo që i propozon mashkullit të adhuruar prej saj dhe jo e kundërta. Romantizmi shfaqet te ndjenjat që na përcjell heroina, veçanërisht te ndjenja e pastër dhe e bukur e dashurisë, që në shpirt fisnik hyn aq lehtësisht.

Tatjana është gjithashtu një vajzë **e lexuar** dhe karakteri i saj është i kultivuar në mënyrë **poetike**. Kjo duket në rreshtat, që ajo aq mjeshtërisht i thurr për Onjeginin. Dhe ngjahson sikur Pushkini poet njëtrajtëson gjeninë e penës së tij me atë të Tatjanës.

Në të njëjtën kohë, që Tatjana është **e guximshme**, është edhe **e përlurur**. Është e guximshme, sepse pavarësisht çdo paragjykimi, ajo bënë një hap të madh drejt emancipimit dhe civilizimit. Por, brenda këtij guximi, ajo është e përlurur përpara objektit të dashurisë të saj. Si romantike, Tatjana e lartëson figurën e atij që dashuron në piedestalet më të larta dhe e çmon kaq shumë, sa mund t'i fali edhe shpirtin. Të dyja këto cilësi të personalitetit të saj burojnë veç prej forcës, që i jep dashuria e madhe që ndjen për Eugjen Onjeginin.

Tania është një vajzë **me parime**. Ajo është **e vetëdijshme** për veprimet që bënë dhe **e ndërgjegjshme** për pasojat. Heroina ka këndvështrimin e saj personal për jetën dhe sipas tij është në gjendje të mos i shkelë parimet e saj.

Si përfundim, Tatjana na shfaqet si një femër **besnike, e ditur, e pastër, e sinqertë** dhe **e dashuruar** në çdo fjalë të letrës. Nëpërmjet lirizmit të thellë, ne kuptojmë se Tania ka një karakter mjaft **pozitiv** dhe **optimist**.

Mjete stilistikore të spikatura të letrës së Tatjanës drejtuar Onjeginit

-Pyetje retorike:

- S'je ti që plot prej dashurie shpres' edhe gas më murmuron?
- Kush je ti? Engjëlli me shpresë, apo një lajkatar pa besë?

-Inversione:

- Jet' edhe fat veç ty që sot t'i kam besuar, më qan me lot shpirt i ngrat e mprojtje vij për të kërkuar
- T'ju them një fjalë, dhe pastaj në zemër veç një mall të mbaj, veç gjer sërish të më takoni

-Retiçenca:

- Po marr guximin t'ju shkruaj...
- Me plot guxim duke shpresuar...

Karakteristika të veprës:

- Dilema, dyshime, apostrofime, përjetime, ndërhyrje të natyrës
- Lirizëm (ndjenja, përshkrime të holla, pasuri shpirtërore)
- Karakter epik
- Ligjërimi në disa veta (më shumë veta e parë)
- Ligjërimi vajzë-djalë, etj.
- Dialog i brendshëm
- Monolog

Lirizmi në vepër:

- Arrin kudo; dëborë' e shtuar
Bje lis - më - lis e shteg - më-shteg;
Si me qilim janë mbuluar
Male - edhe – pyje -e fushë - e breg;
Anët e lumit bardhëloze
U bënë njëjt me shtrat dëbore
- I rridhte plaga gjakatare
Plot avull nënë kraharor;
Para një çasi, njëzë grime,
Kjo zemër thithte frymëzime,
Mëri e shpresë - e dashuri,
Prej jetës zjente gjak' i ri;

Epizmi në vepër

- Bën natë: Tania nuk fle,
I flet nëndesës sy - përdhe
“Ç’kam një si mbytje; s’fle dot, tajë,
Po hap dritarem, dhe ri”.
-Ç’far, bijë? - “Sa mërzi o vajë!
Më folë prapë siç di ti”.
- I vete në një mbrëmje; ja,
Sa hyri...ajo del. Sa e ftohtë!
S’e sheh, një fjalë atij s’i thotë:
Oh si ka ngrirë ajo tashi

KËNGA XXXII (Kreu VI)

Qe shtrirë – i palëvizur fare,

Një nur mbi ballin paqësor.

I rridhte plaga gjakatare

Plot avull nënë kraharor;

Para një çasi, njëzë grime,

Kjo zemër thithte frymëzime,

Mëri e shpresë - e dashuri,

Prej jetës zjente gjak' i ri;

Tashi, si një shtëpi e lënë

Ky zjarri – u shojt e s'ndjehet zë,

Ajo më s'rreh për gjithënjë.

Kapakët janë mbyllur, zënë

Me pluhur xhamet – vaj e lot.

Ku vate zonja? E di një Zot.

Funksioni i mjeteve stilistikore:

Është strofa, ku paraqitet Lenski i vdekur dhe ashtu si edhe çdo strofë tjetër e këtij romani ka katërmbëdhjetë vargje, prandaj quhet **strofë onjeginiane**. Dominon **vargu nëntë rrokësh**, kurse rima është e ndryshueshme. Në fillim është e kryqëzuar, më pas e përputhur, e përmbyllur dhe përsëri e përputhur.

Gjithashtu, strofa është e pasur me figuracion letrar. Në vargjet “Kjo zemër thithte frymëzime” dhe “Prej jetës zjente gjak' i ri” është përdorur **metafora**, me qëllim që ta bëjë më të gjallë skenën, t'i japi më shumë jetë atij, që po vdes dhe t'ia bëjë më të afërt dhimbjen lexuesit.

Epitetet “ballin paqësor” dhe “plaga gjakatare” janë shumë të goditura, si nga autori që i bën një përshkrim preçiz objekteve kryesore të skenës, ashtu edhe nga përkthyesi, që ka gjetur përshtatjen ideale. Lasgushi nuk thotë “gjakësore”, por për ta bërë më të dhimbshme e të kobshme, i ndryshon prapashitesën duke e shndërruar në “gjakatare”.

Përshkallëzimi “mëri e shpresë – e dashuri” është një shkallëzim zbritës, antiklimaks që shpreh zbehjen e inatit, deri në shuarjen e tij, madje shkon deri në metamorfozë, sepse mëria kthehet në dashuri.

Është përdorur **similituda** “si një shtëpi e lënë” për ta bërë më të kuptueshme e të qartë gjendjen e Lenskit. Mbizotërojnë, gjithashtu edhe **kundërvëniet** të ndërtuara mbi epitetet dhe metaforat:

Qe shtrirë – i palëvizur fare - Kjo zemër thithte frymëzime

Ky zjarri – u shojt e s'ndjehet zë - Prej jetës zjente gjak' i ri

Një nur mbi ballin paqësor - I rridhte plaga gjakatare

Këto kontraste janë ndërtuar për të treguar dhe thelluar tragjizmin, që ndan jetën nga vdekjen.